

PROJEKT MARRËVESHJE

PËR BASHKIMIN ME PËRTHITHJE TË SHOQËRIVE TREGTARE “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” SHPK DHE “BSS” SHPK

Sot në Tiranë më datë 01 prill 2022, hartohet ky projekt marrëveshje në kuptim të nenit 216 të ligjit Nr. 9001, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ndërmjet

“INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” shpk, person juridik i themeluar sipas të drejtës shqiptare, i regjistruar në QKB me numër unik identifikimi të subjektit, NIPT L81724027C, me seli në qytetin e Tiranës në adresën Rruga Industriale dytësore, Tiranë - Durrës Km.1, Qendra Pajtoni, Kati 5, Tiranë, i përfaqësuar nga administratori i tij z. Besim Sakajani
Dhe,

“BSS” shpk, person juridik i themeluar sipas të drejtës shqiptare, i regjistruar në QKB me numër unik të identifikimit të subjektit, NIPT L71910025N, me seli në qytetin e Tiranës në adresën Rruga Industriale dytësore, Tiranë - Durrës Km.1, Qendra Pajtoni, Kati 5, Tiranë, i përfaqësuar nga administratori i tij z. Besim Sakajani.

Ky bashkim do të kryhet në formën e përthithjes së një Shoqërie ekzistuese dhe metoda e bashkimit do të jetë metoda e bashkimit të interesave sipas pjesëmarrjes së cilit:

1 - Shoqëritë që marrin pjesë në bashkim.

A – Shoqëria që quhet e Përthithur:

Shoqëria “BSS” shpk, person juridik i themeluar sipas të drejtës shqiptare, e regjistruar në QKB me këto të dhëna;

- numër unik i identifikimit të subjektit NIPT L71910025N,
- seli- Rruga Industriale dytësore, Tiranë - Durrës Km.1, Qendra Pajtoni, Kati 5, Tiranë,
- e përfaqësuar nga administratori i saj z.Besim Sakajani.
- kapitali: 100 000 (njëqind mijë) lekë,
- numri i kuotave: 2 (dy),
- në përqindje 100 % (njëqind për qind)
- 1(një) kuotë, 50%, vlera nominale 50 000(pesëdhjetë mijë) zotëruar nga z. Shkelzen Shahu.
- 1(një) kuotë, 50%, vlera nominale 50 000(pesëdhjetë mijë) zotëruar nga z. Besim Sakajani.

B. – Shoqëria që quhet Përthithëse :

Shoqëria “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” shpk, person juridik i themeluar sipas të drejtës shqiptare, i regjistruar në QKB me këto të dhëna;

- numër unik të identifikimit të subjektit NIPT L81724027C,
- seli- Rruga Industriale dytësore, Tiranë - Durrës Km.1, Qendra Pajtoni, Kati 5, Tiran,
- e përfaqësuar nga administratori i saj z. Besim Sakajani
- kapitali: 100 000 (njëqind mijë) lekë,
- në përqindje 100 % (njëqind për qind)
- numri i koutave: 4 (katër) kuota, zotëruar si vijon:
- një kuotë, 40%(dyzet%), vlera nominale 40 000 (dyzet) mijë zotëruar nga z.Shkelzen Shahu.
- një kuotë,10%(dhjetë%),vlera nominale 10000(dhjetë)mijë zotëruar nga z.Stefanos Papazois
- një kuotë,10%(dhjetë%),vlera nominale 10000(dhjetë)mijë zotëruar nga z.Asterios Ntoumos
- një kuotë, 40% (dyzet %), vlera nominale 40 000 (dyzet)mijë zotëruar nga z.Besim Sakajani

2 - Motivet dhe qëllimi i bashkimit. Pranimi i palëve për bashkim.

- Qëllimi dhe motivi i bashkimit është menaxhimi më i mirë i aktivitetit ekonomik e financiar, zgjerimi i aktivitetit nëpërmjet përthithjes së aktivitetit të Shoqërisë kontribuese, duke realizuar në këtë mënyrë ulje të kostove për njësi, ulje të shpenzimeve administrative, performancë më të lartë në ofrimin e shërbimeve, përballimin e konkurrencës në treg dhe për rrjedhojë rezultate më të mira të fitimit.
- Palët janë plotësisht dakort të shkrijnë veprimtarinë e tyre ekonomike (të drejtat e detyrimet) në një shoqëri të vetme, tashmë të pranuar e miratur në këtë projekt bashkimi.
- Të dyja shoqëritë që marin pjesë në këtë proces kanë aktivitet kryesor të njëjtë, atë të *“Ruajtjes dhe sigurimit fizik të objekteve publike dhe private, sigurimit fizik, ruajtja e jetes dhe shendetit të shtetasve vendas dhe të huaj. Sigurimi fizik, mbrojtja e jetës dhe shëndetit të shtetasve. Ruajtja e objekteve në pronësi ose në përdorim të personave fizik dhe juridik shqiptar ose të huaj, ruajtjen dhe sigurimin e jetës së personave, të vlerave të tyre pasurore gjatë lëvizjes.”*

-Shoqëria përfituese e kontributeve ose Shoqëria përthithëse do të ruaj emrin “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” SHPK në përfundim të këtij procesi.

- Selia e Shoqërisë përfituese të kontributeve do të jetë në Rruga “Industriale” dytësore, Tiranë - Durrës Km.1, Qendra Pajtoni, Kati 5, Tiranë, e përfaqësuar nga administratori i saj z. Besim Sakajani.
- Të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë të përthithur “BSS“ SHPK do ti kalojnë Shoqërisë përthithëse “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS“ SHPK pas përfundimit të operacionit.
- Shoqëria “BSS“ SHPK si shoqëri e përthithur nga Shoqëria “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” SHPK, në përfundim të këtij operacioni do të prishet pa likuidim duke kaluar plotësisht trashëgiminë e saj ekonomike, financiare dhe ligjore tek Shoqëria përthithëse, në gjendjen në të cilën ndodhet kjo trashëgimi në datën e realizimit përfundimtar të operacionit.
- Veprimet e kryera nga data 01 Prill 2022, sipas ligjit 9901 datë 14.04.2008 “PËR TREGTARËT E SHOQËRITË TREGTARE“ neni 215 e deri 225, do të konsiderohen në aspektin e kontabilitetit si të kryera nga Shoqëria që përfiton kontributet “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” SHPK.
- Data 31 Mars 2022, është data në të cilën janë hartuar llogaritë e Shoqërive “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” SHPK si Shoqëri Përthithëse dhe shoqërisë “BSS“ SHPK si Shoqëri të përthithura dhe janë përdorur Bilanci, Pasqyrat financiare, inventarët, gjendjet e tepericave debitore e kreditore si dhe anekset e tjera të tij.

3. Pranimi i palëve për kalimin e pasurisë. Aktivet dhe pasivet (detyrimet) e parashikuara për tu bashkuar

Në kuadrin e këtij operacioni bashkimi parashikon që shoqëria “BSS” SHPK - si Shoqëri e përthithur, ti transferojë (kalojë) shoqërisë “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” SHPK si Shoqëri përthithëse, tërësinë e elementeve të aktivitetit dhe të pasivitetit ashtu si rezultojnë në bilancin e datës 31.03.2022 .

Grupet kryesore të aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë BSS sh.p.k në datën 31.03.2022 janë si më poshtë:

AKTIVET	
Mjete monetare	2,471,052.00
Te drejta te arketueshme	7,442,524
Totali i aktiveve afatshkurtra	9,913,576
Aktive afatgjate-tituj të huadhënies	5,400,000
Aktive materiale	1,920,519
Totali i aktiveve afatgjata	7,320,519
TOTALI I AKTIVEVE-(a)	17,234,095
DETYRIMET	
Detyrime afatshkurtra	19,108,869
Detyrime afatgjata	0
TOTALI I DETYRIMEVE -(b)	19,108,869
AKTIVET NETO(kapitali + fitimet) a-b	(1,874,774)

Në datën e bashkimit efektiv, 30 qershor 2022, këto të dhëna do të përditësohen me transaksionet që mund të zhvillohen gjatë periudhës janar-qershor 2022. Vlera e aktiveve neto do ti bashkkohej kapitalit të shoqërisë përthithëse.

4. – Modalitetet. Raportet e këmbimit të aksioneve apo kuotave. Kushtet e ndarjes. Të drejtat që rrjedhin nga kuotat në shoqërinë përthithëse.

Përkundrejt kalimit të aktiveve në shoqërinë përthithëse “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS“ SHPK, Ortakët e shoqërisë „BSS“, z.Shkëlzen Shahu dhe z.Besim Sakajani, meqënëse janë dhe ortak në shoqërinë përthithëse si dhe në shoqërinë e përthithur, kërkojnë që kapitali i nënshkruar i të dy shoqërive të bashkohet në një, duke rritur vlerën nominale të kuotave sipas raportit të deklaruar në shoqërinë „INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS“ para bashkimit.

Shoqëria “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS“ SHPK gëzon frutet e kontributit të shoqërisë “BSS“ SHPK duke filluar nga data e realizimit të bashkimit në fjalë.

Para fillimit të procedurave të bashkimit, kapitali themeltar i shoqërisë „INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS“ SHPK është 100 000 lekë dhe mbas procedurës të bashkimit kapitali i nënshkruar bëhet 200 000 lekë, (i cili veç kapitalit të „INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS“ sh.p.k ka dhe 100 000 lekë të „BSS“ sh.p.k.

Pas realizimit të operacionit do të kemi një shoqëri të vetme „PËRTHITHËSE“ e emërtuar “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS“ SHPK.

5. Data kontabël

Ne aspektin e kontabilitetit të gjitha operacionet e veprimtarisë të kryera prej shoqërisë “BSS“ SHPK nga data 01.04.2022 e deri në datën e realizimit të bashkimit, pra data 01.07.2022 do të konsiderohen si të kryera nga shoqëria përthithëse “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS“ SHPK dhe regjistrimet përkatëse kontabël do të merren në librat e saj.

6. Vlerat e parashikuara të primit

Të dhënat e shprehura në pikën tre më sipër të këtij projekt bashkimi, përdoren vetëm si referencë për aktivitetin e shoqërisë së përthithur. Të dhënat që do të konsiderohen si të detyrueshme dhe të aplikueshme në këtë procedurë bashkimi do të jenë ato që do të rezultojnë nga pasqyrat financiare të shoqërisë në datën 30.06.2022. Primi i bashkimit do të jetë ai që do të llogaritet mbi të dhënat që do të rezultojnë nga bilanci i lartpërmendur.

7. Të drejta dhe avantazhe të vecanta

Ky operacion bashkimi nuk do të përmbajë as të drejta dhe as ndonjë avantazh të veçantë.

8. Raportet

- Për të hartuar raportin e bashkimit të shoqërive, e kërkuar nga neni 217 i ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” caktohet eksperti kontabël i autorizuar Z.Gentian Barjamaj, i cili do të bëjë edhe vlerësimin e këtij bashkimi me përthithje, sipas metodës së bashkimit të interesave të shoqërisë që do të përthithet “BSS” shpk dhe raportin për zmadhimin e kapitalit si pasojë e kalimit në favor të shoqërisë përthithëse “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS ” shpk.
- Me përfundimin e raportit të parashikuar më sipër, kjo marrëveshje dhe raporti i ekspertit do të miratohen nga Asambletë e Përgjithshme të jashtëzakonshme të Ortakëve të secilës shoqëri.
- Me përfundimin e raportit 1(një) muaj përpara mbledhjeve respektive të Asambleve të Përgjithshme të Ortakëve, kjo marrëveshje dhe raporti i miratuar i ekspertëve do të publikohen në QKB sipas parashikimeve të nenit 218 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Ky projekt bashkimi hartohet e nënshkruhet në kushtin e varësisë së miratimit nga Asambleja e Përgjithshme e jashtëzakonshme e secilës prej shoqërive pjesëmarrëse pas datës 01.07.2022.

9. Funksionimi i Shoqërisë Përthithëse “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” shpk.

Shoqëria “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” shpk do të vazhdojë të funksionojë sipas të njëjtit sistem organizimi e nomenklaturë me Aktin e themelimit, Statutin e saj, në të cilën janë theksuar:

- Emri i shoqërisë - “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS SHPK.
- Selia - Selia e shoqërisë do të vazhdojë të jetë në adresën Rruga Industriale dytësore Tirane - Durrës Km.1, Qendra Pajtoni, Kati 5, Tirane,
- Kohëzgjatja – E pakufizuar.
- Veprimtaria - Do të jetë e njëjtë me veprimtarinë e shoqërisë përthithëse para bashkimit.
- Administrator i vetëm do të jetë Besmir Sakajani.
- Të gjithë kreditorët që rezultojnë si të tillë të shoqërisë që do të përthithet “BSS” shpk do të konsiderohen si të tillë, dhe detyrimet e tyre nuk do të çenohen nga kjo marrëveshje. Për të mbrojtur kreditorët e shoqërisë që do të përthithet “BSS” shpk, administratori i këtyre shoqërive do të lëshojë në emër dhe në favor të tyre një deklaratë me shkrim, me anë të së cilës pranohet se pasuritë e shoqërive do të administrohen në mënyrë të veçantë deri në përmbushjen e detyrimeve të të gjithë kreditorëve. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive që bashkohen, përgjigjen në mënyrë solidare për të gjitha dëmet e shkaktuara kreditorëve, si pasojë e pasaktësisë së deklaratës së përmendur në këtë pikë.
- Duke marrë në konsideratë faktin se të dy shoqëritë si ajo përthithëse dhe ajo e përthithur, kanë objekt të njëjtë veprimtarie kjo marrëveshje, por njëra nga shoqëritë nuk ka aktivitet, nuk është subjekt i klazulave të ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, për të cilin kërkohet miratim në përputhje me kërkesat e këtij ligji, para bashkimit të shoqërisë.

10. Pasoja për të punësuarit pas bashkimit.

Të gjithë të punësuarit në administratë apo puntorë të tjerë të shoqërisë së përthithur “BSS” shpk, do të vazhdojnë të punojnë në Shoqërinë “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS“ SHPK sipas një organizimi të ri, por nuk ka asnjë pushim apo pezullim nga puna për shkak të këtij bashkimi.

Hartuar në Tiranë , më 01/04/2022

Për “BSS” shpk

ADMINISTRATORI

(Z.Besim Sakajani)



Për Shoqërinë “INTERNATIONAL
PRIVATE SECURITY IPS“ shpk

ADMINISTRATORI

(Z.Besim Sakajani)



RAPORTI I ADMINISTRATORIT

TË SHOQËRISË TREGTARE “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” SHPK
PËR BASHKIMIN ME PËRTHITHJE

“INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” shpk, është person juridik i themeluar sipas të drejtës shqiptare, i regjistruar në QKB me numër unik identifikimi të subjektit, NIPT L81724027C. Shoqëria “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” shpk, person juridik i themeluar sipas të drejtës shqiptare, i regjistruar në QKB me këto të dhëna;

- numër unik të identifikimit të subjektit NIPT L81724027C,
- seli- Rruga Industriale dytesore, Tiranë - Durrës Km.1, Qendra Pajtoni, Kati 5, Tiran,
- e përfaqësuar nga administratori i saj z. Besim Sakajani
- kapitali: 100 000 (njëqind mijë) lekë,
- në përqindje 100 % (njëqind për qind)
- numri i koutave: 4 (katër) kuota, zotëruar si vijon:
- një kuotë, 40%(dyzet%), vlera nominale 40 000 (dyzet) mijë zotëruar nga z.Shkelzen Shahu.
- një kuotë,10%(dhjetë%),vlera nominale 10000(dhjetë)mijë zotëruar nga z.Stefanos Papazois
- një kuotë,10%(dhjetë%),vlera nominale 10000(dhjetë)mijë zotëruar nga z.Asterios Ntoumos
- një kuotë, 40% (dyzet %), vlera nominale 40 000 (dyzet)mijë zotëruar nga z.Besim Sakajani

Shoqëria ka si objekt të aktiviteti të saj ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve publike dhe private, sigurimin fizik, ruajtja e jetës dhe shëndetit të shtetasve vendas dhe të huaj. Sigurimi fizik, mbrojtja e jetës dhe shëndetit të shtetasve. Ruajtja e objekteve në pronësi ose në përdorim të personave fizik dhe juridik shqiptar ose të huaj, ruajtjen dhe sigurimin e jetës së personave, të vlerave të tyre pasurore gjatë lëvizjes.

Shoqëria e ka filluar aktivitetin e saj pas regjistrimit në QKB, më datën 24/05/2018 dhe që nga ajo kohë ka zhvilluar aktivitetin e saj normal, brenda gjithë kuadrit ligjor regullator jo vetëm për sa i takon ligjeve të fushës së saj të veprimit, por edhe në lidhje me legjislacionin fiskal, legjislacionin e punës, si dhe të gjitha aktet e tjera që prekin veprimtarinë e saj të përditshme.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, shoqëria ka mbajtur gjithmonë parasysh edhe ndikimin e saj dhe mardhëniet me palët e treta duke treguar kujdes si për anën materiale të mardhënieve ashtu edhe për anën njerëzore, nëpërmjet respektimit të të drejtave dhe detyrimeve të saj në lidhje me komunitetin.

Veprimtaria e shoqërisë për këtë periudhë ka qenë e përqëndruar në shërbimet e ruajtjes e sigurisë dhe nga viti në vit ka ardhur duke u rritur.

Gjithashtu ky treg, sipas të dhënave dhe vrojttimeve të kryera nga ana jonë është dhe për një periudhë afatshkurtër do të mbetet një treg në zgjerim.

Për vetë kushtët e tregut ku shoqëria vepron, ka pasur dhe ka edhe vështirësi të natyrshme që lidhen me kërkesat gjithnjë e në rritje për shërbime të sakta dhe të sigurta, zgjerimi i gamës së shërbimeve

INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS sh.p.k

NIPT: L81724027C, Adresa: Lagjia Fushe-Mezez, Rruga Industriale dytesore Tirane - Durres
Km.1,Qendra Pajtoni,Kati 5, Mëzez, Kashar-Tiranë

të kërkuara me shpejtësi shumë të madhe, mundësia e përshtatjes së këtyre kërkesave me aftësitë dhe kapacitetet që shoqëria ka mundësi të ofrojë, kufizimeve të natyrshme të personelit të shoqërisë. Këto kufizime vijnë si për sa i takon numrit të personelit të cilin shoqëria mund të mbajë në dispozicion për të realizuar shërbimet që ka kontraktuar me klientët e saj dhe që nuk mund të jetë shumë më tepër se sa nevojitet, por edhe për sa i takon kualifikimeve të tyre, lëvizshmërisë dhe pasigurisë që këta punonjës mund të vazhdojnë gjatë të kryejnë detyrat e tyre pranë shoqërisë, kualifikimeve paraprake të kërkuara për të ushtruar këtë lloj pune etj.

Shoqëria ia ka dalë më së miri të harmonizojë përvojën e saj modeste me përvojën e drejtuesve të saj si dhe me atë të personelit dhe nëpërmjet kësaj të përmbushë detyrimet kundrejt palëve të treta. Situata financiare dhe treguesit ekonomikë, të cilët paraqiten në grafikat në vijim, japin besueshmëri dhe siguri të lartë për të ardhmen e shoqërisë në këtë treg.

Periudha	2021	2020	2019	2018
Totali i aktiveve afatshkurtra	77,550,010	84,041,384	69498555	2905750
Aktive materiale	10,594,721	11,119,151	3614797	125500
TOTALI I AKTIVEVE	88,144,731	95,160,535	73113352	3031250
Totali i detyrimeve afatshkurta	21,520,424	34,613,955	65721468	3329330
Totali i detyrimeve afatgjata	0	0	0	0
Detyrime totale	21,520,424	34,613,955	12919445	3259000
Kapitali i nenshkruar	100	100	100	100
Fitimi/(humbja) e periudhes	66,624,207	60,546,480	60193807	-227850
TOTALI I DET. DHE KAPITALIT	88,144,731	95,160,535	73113352	3031250

Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit	131,742,658	111,595,544	95150855	0
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	-	-	0	0
Shpenzime te personelit	(44,433,962)	(32,351,021)	17283673	-226150
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	(2,655,622)	(1,539,765)	-277684	
Shpenzime te tjera shfrytëzimi	(6,159,387)	(6,465,857)	-6541537	-1700
Shpenzime financiare	(59,356)		-559	
Fitimi/(humbja) para tatimit	78,434,331	71,238,901	71047402	-227850
Tatimi mbi fitimin e periudhes	(11,810,124)	(10,692,421)	10625745	
Fitimi/(Humbja) e periudhes/vitit (A)	66,624,207	60,546,480	60421657	-227850

Siç shihet dhe nga tabela me treguesit më sipër, shoqëria ka rritje në parametrat e saj ekonomikë dhe burimeve të saj të punës. Ka siguri se këto mjetë dhe burime do të përballojmë me sukses detyrat dhe detyrimet e saj për të ardhmën.

INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS sh.p.k

NIPT: L81724027C, Adresa: Lagjia Fushe-Mezez, Rruga Industriale dytesore Tirane - Durres
Km.1,Qendra Pajtoni,Kati 5, Mëzez, Kashar-Tiranë

Gjithashtu po të shikohe shifra e afarizmit, xhiro e realizuar, dallohet lehtë se kjo shifër, pasi ka arritur një nivel të caktuar në vitin 2019, rritja e saj është ngadalësuar shumë dhe është dukshëm nën rritjen dhe zgjerimin e tregut.

Në kushtet e mësipërme, për një harmonizim sa më të mirë të punëve dhe mundësive të shoqërisë tonë, dhe për të përfituar sa më shumë nga përvoja e gjatë dhe klientela dhe besueshmëria në treg e shoqërisë BSS sh.p.k, është menduar që këto dy drejtime shumë të rëndësishme për ofrimin e shërbimeve në këtë lloj tregu, të shkrihen dhe harmonizohen në një shoqëri të vetme.

Nga kjo do të përfitojnë të gjithë pjesëmarrësit në këtë proces, dhe sidomos do të reduktohen shumë kosto fikse dhe administrative si dhe do të shfrytëzohen më mirë potencialet e të dy shoqërive duke i harmonizuar më mirë avantazhet konkurruese të secilës në një ofertë të vetme fituese.

Hartuar në Tiranë , më 29/03/2022

Për Shoqërinë "INTERNATIONAL
PRIVATE SECURITY IPS" shpk

ADMINISTRATORI

(Z.Besim Sakajani)

Besim Sakajani



RAPORTI I ADMINISTRATORIT

TË SHOQËRISË TREGTARE "BSS" SHPK PËR BASHKIMIN ME PËRTHITHJE

"BSS" shpk, person juridik i themeluar sipas të drejtës shqiptare, i regjistruar në QKB me numër unik të identifikimit të subjektit, NIPT L71910025N, me seli në qytetin e Tiranës në adresën Rruga Industriale dytësore, Tiranë - Durrës Km.1, Qendra Pajtoni, Kati 5, Tiranë, i përfaqësuar nga administratori i tij z. Besim Sakajani.

Shoqëria "BSS" shpk, person juridik i themeluar sipas të drejtës shqiptare, e regjistruar në QKB me këto të dhëna;

- numër unik i identifikimit të subjektit NIPT L71910025N,
- seli- Rruga Industriale dytësore, Tiranë - Durrës Km.1, Qendra Pajtoni, Kati 5, Tiranë,
- e përfaqësuar nga administratori i saj z. Besim Sakajani.
- kapitali: 100 000 (njëqind mijë) lekë,
- numri i kuotave: 2 (dy),
- në përqindje 100 % (njëqind për qind)
- 1 (një) kuotë, 50%, vlera nominale 50 000 (pesëdhjetë mijë) zotëruar nga z. Shkelzen Shahu.
- 1 (një) kuotë, 50%, vlera nominale 50 000 (pesëdhjetë mijë) zotëruar nga z. Besim Sakajani.

Shoqëria ka si objekt të aktiviteti të saj ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve publike dhe private, sigurimin fizik, ruajtja e jetës dhe shëndetit të shtetasve vendas dhe të huaj. Sigurimi fizik, mbrojtja e jetës dhe shëndetit të shtetasve. Ruajtja e objekteve në pronësi ose në përdorim të personave fizik dhe juridik shqiptar ose të huaj, ruajtjen dhe sigurimin e jetës së personave, të vlerave të tyre pasurore gjatë lëvizjes.

Shoqëria e ka filluar aktivitetin e saj pas regjistrimit në QKB, më datën 10/07/2017 dhe që nga ajo kohë ka zhvilluar aktivitetin e saj normal, brenda gjithë kuadrit ligjor regullator jo vetëm për sa i takon ligjeve të fushës së saj të veprimit, por edhe në lidhje me legjislacionin fiskal, legjislacionin e punës, si dhe të gjitha aktet e tjera që prekin veprimtarinë e saj të përditshme.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, shoqëria ka mbajtur gjithmonë parasysh edhe ndikimin e saj dhe mardhëniet me palët e treta duke treguar kujdes si për anën materiale të mardhënieve ashtu edhe për anën njerëzore, nëpërmjet respektimit të të drejtave dhe detyrimeve të saj në lidhje me komunitetin.

Gjithashtu ky treg, sipas të dhënave dhe vrojttimeve të kryera nga ana jonë është dhe për një periudhë afatshkurtër do të mbetet një treg në zgjerim.

Për vetë kushtët e tregut ku shoqëria vepron, ka pasur dhe ka edhe vështirësi të natyrshme që lidhen me kërkesat gjithnjë e në rritje për shërbime të sakta dhe të sigurta, zgjerimi i gamës së shërbimeve

BSS SH.P.K

NIPT L71910025N; Adresa: "Lagjja Fushe-Mezes", Rr. Industriale Tirane-Durres, km.1 Qendra "Pajtoni", Kati 5, Tirane Kashar

të kërkuara me shpejtësi shumë të madhe, mundësia e përshtatjes së këtyre kërkesave me aftësitë dhe kapacitetet që shoqëria ka mundësi të ofrojë, kufizimeve të natyrshme të personelit të shoqërisë. Këto kufizime vijnë si për sa i takon numrit të personelit të cilin shoqëria mund të mbajë në dispozicion për të realizuar shërbimet që ka kontraktuar me klientët e saj dhe që nuk mund të jetë shumë më tepër se sa nevojitet, por edhe për sa i takon kualifikimeve të tyre, lëvizshmërisë dhe pasigurisë që këta punonjës mund të vazhdojnë gjatë të kryejnë detyrat e tyre pranë shoqërisë, kualifikimeve paraprake të kërkuara për të ushtruar këtë lloj pune etj.

Shoqëria nuk ia ka dalë më së miri të harmonizojë përvojën e saj modeste me përvojën e drejtuesve të saj si dhe me atë të personelit dhe nëpërmjet kësaj të përmbushë detyrimet kundrejt palëve të treta.

E gjendur në këto kushte të vështira dhe me një konkurrencë gjithnjë e në rritje, shoqëria ka pasur vështirësi serioze në përmbushjen e detyrimeve të saj kontraktuale dhe aktualisht nuk ka kontrata aktive.

Situata financiare dhe treguesit ekonomikë, të cilët paraqiten në grafikat në vijim, japin me besueshmëri dhe siguri të lartë se në të ardhmen shoqëria do të ketë vështirësi mbijetese.

Periudha	2021	2020	2019	2018
Totali i aktiveve afatshkurtra	9,913,576	9,060,723	41,590,987	46,978,962
Aktive materiale	7,320,519	8,470,486	7,078,635	7,436,063
TOTALI I AKTIVEVE	17,234,095	17,531,209	48,669,622	54,415,025
Totali i detyrimeve afatshkurta	19,108,869	19,140,908	50,009,853	4,355,554
Totali i detyrimeve afatgjata	-	-	-	-
Detyrime totale	19,108,869	19,140,908	50,009,853	4,355,554
Kapitali i nenshkuar	100,000	100,000	100,000	100,000
Rezerva te tjera	1,386,562	1,386,562	1,386,562	1,386,562
Fitimi/(humbja) e periudhes	(3,361,336)	(3,096,261)	(2,826,793)	48,572,909
TOTALI I DET. DHE KAPITALIT	17,234,095	17,531,209	48,669,622	54,415,025
Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit	1,149,967	7,678,288	59,421,147	117,689,218
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	-	(2,997,498)	-	-
Shpenzime te personelit	-	(1,977,795)	(46,739,584)	(53,342,763)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	-	(1,259,790)	(1,685,554)	(1,266,201)
Shpenzime te tjera shfrytezimi	(1,397,576)	(1,712,355)	(13,822,416)	(5,901,713)
Shpenzime financiare	(17,466)	(318)	(386)	9,713
Fitimi/(humbja) para tatimit			(2,826,793)	57,188,254
Tatimi mbi fitimin e periudhes				(8,615,345)
Fitimi/(Humbja) e periudhes/vitit (A)	(265,075)	(269,468)	(2,826,793)	48,572,909

BSS SH.P.K

NIPT L71910025N; Adresa: "Lagjja Fushe-Mezes", Rr. Industriale Tirane-Durres, km.1 Qendra "Pajtoni", Kati 5, Tirane Kashar

Kjo shoqëri në kushtet që ndodhet e sheh me vend dhe me përfitim bashkimin e mjeteve, burimeve dhe përvojave të saj me dinamikat e shoqërise IPS sh.p.k.

Hartuar në Tiranë , më 29.03.2022

Për "BSS" shpk
ADMINISTRATORI

(Z.Besim Sakajani)

Besim Sakajani





Albanian Consultancy

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

PËR ASAMBLENË E ORTAKËVE TË SHOQËRISË “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” SH.P.K

Zotërinj të nderuar!

Në ekzekutim të misionit që më është besuar nga ju, kam nderin t'ju paraqes raportin mbi pasqyrimin e gjendjeve financiare të ushtrimit që mbulon periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2021. Unë kam audituar pasqyrat financiare të shoqërisë të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyra e fluksit të parasë dhe pasqyra e ndryshimeve të kapitalit të vetë për vitin e mbyllur në atë datë si dhe një përmbledhje të metodave të rëndësishme kontabël dhe shënimeve të tjera anekse.

OPINIONI

Sipas opinionit tim si auditues, pasqyrat financiare japin një pamje reale, të vërtetë dhe të sinqertë të pozicionit financiar të shoqërisë “INTERNATIONAL PRIVATE SECURITY IPS” SH.P.K më 31.12.2021, të performancës financiare dhe fluksit të parave për vitin që mbyllet, në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit.

BAZA E OPINIONIT

Auditimi ka përfshirë kryerjen e procedurave për të marrë evidencë auditimi rreth shumave dhe informacioneve të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga audituesi, përfshirë këtu edhe vlerësimin mbi gjykimet e vlerësimet e përdorura nga ana e shoqërisë në përgatitjen e pasqyrave financiare, të metodave e politikave kontabël të ndjekura në përputhje me veçoritë e veprimtarisë së saj.

Ai është mbështetur mbi informacione dhe shpjegimet e vëna në dispozicion pa asnjë rezervë nga ana e shoqërisë, në sondazhet dhe testimet e kryera të konsideruara të mjaftueshme për mbështetjen e opinionit mbi gjendjet financiare të shoqërisë për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2021.



Albanian Consultancy

Në formimin e opinionit të auditit u vlerësua gjithashtu dhe saktësia e prezantimit të informacionit dhe ndryshimet e nevojshme të cilat u gjykuan me vend dhe që u pasqyruan në pasqyrat financiare dhe anekset përkatëse.

PËRGJEGJËSITË E DREJTIMIT

Drejtimi i shoqërisë, që ka përgatitur pasqyrat financiare dhe infomacionin plotësues përkatës, mbajnë përgjegjësi të plota për saktësinë e tyre në përputhje me standartet kombëtre të kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm të përshtatshëm mbi përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, zgjedhjen e metodave të përshtatshme kontabël dhe kryerjen e çmuarjeve kontabël të arsyeshme për rrethanat.

PËRGJEGJËSITË E AUDITUESIT

Është përgjegjësia ime si auditues i pavarur të shpreh opinion të arsyeshëm mbi këto pasqyra, duke u mbështetur në standartet ndërkombëtare të auditimit, në normat dhe kërkesat e profesionit, për të marrë një siguri të arsyeshme nëse pasqyrat nuk kanë anomali materiale dheta raportoje atë para jush.


Për ALBANIAN CONSULTANCY

Gentian Barjamaj

Auditues Ligjor-Liç.Nr.229

30 mars 2022

Rruga "Sami Frashëri" P.Titan,

Kati i 10, Nr. 34 - Tiranë



Russell Bedford
taking you further

Albanian Consultancy

Member of Russell Bedford International- a global network of independent professional services firms
Rr. "Sami Frashëri", P. Titan Konstruksion, K. 10, Nr.34-Tiranë - T: +355 4 450 3233